

20180110125

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR VEPRIMTARI FILMIKE

Neni 1

Në Ligjin për veprimtari filmike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 82/13, 18/14, 44/14, 129/15, 152/15 dhe 39/16), në nenin 15 paragrafi (5) pika 5) në alinenë 4 lidhëza "ose" zëvendësohet me presje.

Në alinenë 5 lidhëza "dhe" zëvendësohet me lidhëzën "apo".

Pas alinesë 5 shtohet alineja e re 6, si vijon:

"- APTIS (APTIS) - së paku niveli B2 (B2)".

Pika 6) shlyhet.

Neni 2

Në nenin 19 në paragrafin (2) fjalët: "gjashtë muajt e fundit" zëvendësohen me fjalët: "afatin e përcaktuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, që nuk mund të jetë më i gjatë se gjashtë muaj".

Në paragrafin (3) fjalët: "gjashtë muajt " zëvendësohen me fjalët: "afatin nga paragrafi (2) i këtij neni".

Neni 3

Dispozitat e nenit 15 paragrafi (5) pika 5) të Ligjit për veprimtari filmike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 82/13, 18/14, 44/14, 129/15, 152/15 dhe 39/16), dhe dispozitat e nenit 1 të këtij ligji me të cilin në nenin 15 paragrafi (5) pika 5) pas alinesë 5 shtohet alineja e re 6, nuk do të zbatohen nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 1 shtator 2018.

Neni 3

Drejtori që emërohet në periudhën nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 1 shtator 2018, obligohet ta përmbushë kushtin për njohjen e gjuhës së huaj më së voni në afat prej një viti nga dita e emërimit të tij.

Drejtorit i cili nuk do ta përmbushë kushtin për njohjen e gjuhës së huaj në afatin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni i pushon mandati.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".